



THIRRJE E HAPUR PËR PJESËMARRJE “Kampin e të Rinjve”

THIRRJE PËR PJESËMARRJE

Projekti: RISE Balkans – Fuqizimi i Zërit të të Rinjve: Përgjegjësi, Integritet, Solidaritet dhe Angazhim Qytetar në Ballkan (Projekti Nr. 101253022) në kuadër të programit CERV të Bashkimit Evropian

Periudha e aplikimit: 1 Qershor 2026 – 20 Qershor 2026

Organizata zbatuese: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Jemi në kërkim të të rinjve të motivuar që dëshirojnë të:

- Angazhohen në aktivitete qytetare dhe procese demokratike
- Zhvillojnë aftësi në hartimin e politikave dhe advokim
- Bashkëpunojnë me bashkëmoshatarë nga sektorë të ndryshëm
- Angazhohen në aksione qytetare konkrete dhe të zbatueshme

Inkurajojmë aplikimet nga pjesëmarrës me eksperiencë të ndryshme; pjesëmarrësit mund të kenë eksperiencë të mëparshme në procese të ngjashme angazhimi, por mund të jenë dhe fillestarë, të rinj nga zonat urbane dhe rurale, si dhe në etapa të ndryshme të arsimit apo jetës profesionale.

Përvoja paraprake në advokim apo hartim politikash nuk është kusht.

Synimi ynë është ta bëjmë këtë aktivitet sa më gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm. Pjesëmarrësit me nevoja të veçanta për akses inkurajohen të aplikojnë pasi do të sigurohet pjesëmarrja e tyre.

Kriteret e pranueshmërisë:

- Moshë: 18–26 vjeç
- Interes dhe pasion për angazhimin qytetar dhe ndryshimin shoqëror
- Mundësi për të marrë pjesë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kampit.
- Prioritet do t’u jepet të rinjve me akses të kufizuar në mjete dhe mundësi pjesëmarrjeje



ÇFARË ËSHTË KAMPI I TË RINJVE?

Është një program intensiv dhe praktik i edukimit qytetar, ku ju do të:

- Simuloni procese reale të hartimit të politikave
- Praktikoni teknika të advokimit demokratik
- Bashkëkrijoni aktivitete dhe nisma mobilizimi qytetar
- Punoni në ekipe ndërdisiplinore
- Zhvilloni propozime konkrete politikash të udhëhequra nga të rinjtë
- Krijoni rrjete bashkëpunimi me të rinj të tjerë nga Shqipëria.

Data(t): Tetor – Nëntor 2026

Vendndodhja: Tiranë, Shqipëri

Formati: Sesione interaktive me pjesëmarrje fizike

ÇFARË DO TË FITONI?

- **Zhvillim aftësish:** Njohuri të avancuara mbi proceset demokratike, advokimin e politikave dhe angazhimin qytetar
- **Eksperiencë praktike:** Punë konkrete në krijimin e iniciativave reale qytetare
- **Rrjetëzim:** Mundësi për t'u lidhur me të rinj të motivuar dhe profesionistë nga sektorë të ndryshëm
- **Vlerësim dhe njohje:** Certifikatë pjesëmarrjeje dhe portofol me punën tuaj
- **Ndikim:** Propozimet tuaja mund të shndërrohen në projekte reale qytetare edhe pas përfundimit të kampit.

SI TË APLIKONI

[Plotësoni këtu formularin online të aplikimit](#)

Formulari i aplikimit duhet të përfshijë:

- Emrin
- Gjininë
- Moshën
- Të dhënat e kontaktit (email, telefon, rrjete sociale)
- Kombësinë
- Vendbanimin
- Profesionin / angazhimin aktual





Motivimi (maksimumi 300 fjalë), duke shpjeguar:

- Pse dëshironi të merrni pjesë
- Interesin tuaj për angazhimin qytetar
- Çfarë shpresoni të arrini nga kjo eksperiencë

✓ PROCESI I PËRZGJEDHJES

Afatet kohore:

- Dorëzimi i aplikimeve: **deri më 20 Qershor 2026**
- Njoftimi i përzgjedhjes: **Shtator 2026**
- Sesioni orientues/informues: **tetor 2026**

Kriteret e përzgjedhjes:

- Interes i dëshmuar për angazhimin qytetar
- Motivim dhe përkushtim
- Diversitet dhe përfaqësim (gjeografik, sektorial, demografik)
- Potencial për të kontribuar në dinamikën e ekipit
- Prioritet për grupet e nën-përfaqësuar dhe të rinjtë me akses të kufizuar në pjesëmarrje

✦ HAPAT E ARDHSHËM PËR PJESËMARRËSIT E PËRZGJEDHUR

Të gjithë pjesëmarrësit e përzgjedhur do të ftohen në një Sesion Informues ku do të:

- Prezantojmë strukturën dhe objektivat e Kampit të të Rinjve
- Ndajmë shembuj të iniciativave rinore të mëparshme
- Përgjigjemi pyetjeve tuaja
- Sqarojmë pritshmëritë dhe aspektet logjistike

? PYETJE?

Për më shumë informacion, kontaktoni:

Email: partners@partnersalbania.org

🔗 LINQE TË DOBISHËM

Informacion mbi projektin: <https://www.partnersalbania.org/News/rise-balkans-fuqizimi-i-zerit-te-te-rinjve-pergjegjiesi-integritet-solidaritet-dhe-angazhim-qytetar-ne-ballkan/>

RISE Balkans në rrjetet sociale: www.risebalkans.eu

[instagram.com/risebalkans](https://www.instagram.com/risebalkans)

[linkedin.com/in/eurocrim-project-eu](https://www.linkedin.com/in/eurocrim-project-eu)



Funded by
the European Union

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to.



⚠ SHËNIME TË RËNDËSISHME

- Të gjithë pjesëmarrësit duhet të jenë të disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kampit
- Nuk ka tarifë pjesëmarrjeje
- Të dhënat personale do të përpunohen në përputhje me GDPR dhe politikën e privatësisë së projektit
- Kjo thirrje e hapur është pjesë e një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian

APLIKO TANI!

Afati i fundit: 20 Qershor 2026

“Kampet e të Rinjve” janë krijuar për t’i ndihmuar të rinjtë të kalojnë nga ndërgjegjësimi në veprim.”